



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1646/2026

Data: 16.02.2026

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e parë - I - për vitin 2026 mbajtur me datë: 20.01.2026 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për komunitete.
2. Hartimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2026.

Florim Shkreta (Kryesues i Kuvendit të Komunës): Fillimisht ju përshëndes dhe ju uroj për mandatin si anëtarë të Komitetit për Komunitete. Si Kryesues i Kuvendit të Komunës e kam thirrur mbledhjen e parë me këtë rend të punës. Nëse jeni në pajtim, vazhdojmë me këtë rend të punës. Pasi që të gjithë jeni të pajtimt, vazhdojmë me këtë rend të punës.

1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për komunitete.

Florim Shkreta (Kryesues i Kuvendit të Komunës): Ju duhet të propozoni kandidat për kryesues të Komitetit për Komunitete, pra secili prej jush ka të drejtë të propozojë.

Ibadete Kuka: Propozoj z. Basri Dernjani për Kryesues të Komitetit për Komunitete.

Sead Vila: Unë mendoj që kryesuesi duhet të jetë nga opozita, në mënyrë që edhe opozita të jetë e përfshirë. Për kryesues të komitetit propozoj znj. Valmira Bushi.

Valmira Bushi: Shumë faleminderit që më propozuat, por unë jam për herë të parë dhe mendoj që të jem vetëm anëtare e komitetit.

Florim Shkreta (Kryesues i Kuvendit të Komunës): A keni ndonjë propozim tjetër? Nëse nuk ka, e hedh në votim propozimin. Rezultati i votimit ishte njëzëri. Pra, z. Basri Dernjani zgjidhet Kryesues i Komitetit për Komunitete. Ftoj z. Basri Dernjani, nga ky moment, që të vazhdojë me udhëheqjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Faleminderit, Kryesues i Kuvendit të Komunës, z. Florim Shkreta. I falënderoj të gjithë anëtarët e komitetit për besimin e dhënë. Do të punojmë bashkërisht dhe të gjitha vendimet do t'i marrim bashkërisht. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të punës.

2. Hartimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026

Kryesuesi: Pasi që materiali i Kuvendit të Komunës përcillet nesër, do të mundohemi që draft-planin ta hartojmë dhe ta përcjellim. Nëse keni ndonjë propozim, mund ta përcillni deri ditën e nesërme. Për muajin qershor propozoj që të kemi një takim me drejtorin e arsimit. A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:15.

Procesmbajtës

Ayni Bush



Kryesuesi i Komitetit
Basri Derrjani

